



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Projekt L I G J

(Nr. __, datë __ 2023)

PËR ZBATIMIN E PËRGJEGJËSIVE TË ZGJERUARA TË PRODHUESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim ngritjen dhe funksionimin e skemës për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit (në vijim "PZP"), në mënyrë që çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale, produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

Neni 2

Objekti i ligjit

1. Ky ligj përcakton:

a) masat e nevojshme që merr prodhuesi i produktit për të mbajtur përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, me qëllim rritjen e ripërdorimit, parandalimit, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve;

b) kushtet për vendosjen për herë të parë në treg të produkteve PZP nga ana e prodhuesit, për të garantuar realizimin e objektivave kombëtare të grumbullimit të mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rrymat specifike të mbetjeve;

c) rregullat për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit (në vijim "SHPZP");

- c) kërkesat për autorizimin e SHPZP që mbajnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit;
- d) rregullat për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të prodhuesve PZP dhe SHPZP që zbatojnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit;
- dh) rregullat për informimin e konsumatorëve, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të gjeneruara dhe zvogëlimin e rrezikut nga produktet në fazën pas konsumit.

Neni 3 Përkufizime

Termtat e përdorur në këtë ligj kanë të njëjtin kuptim me termtat e ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, përveç kur parashikohet ndryshe si më poshtë:

1. “Autorizim” është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. “Kontrata” është marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur ndërmjet SHPZP dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e skemës së PZP, ngritjen e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe përmbushjen e objektivave kombëtare në menaxhimin e mbetjeve.

3. “Ministri” është ministri përgjegjës për mjedisin.

4. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

5. “Përdorues i fundit” është çdo person fizik ose juridik që përdor produktin për konsum final.

6. “Prodhues” është çdo prodhues i produktit, person fizik apo juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon, produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit.

7. “Prodhues i kontraktuar” është prodhuesi i produkteve pjesë e skemës PZP, detyrimet e të cilit për PZP janë marrë përsipër nga SHPZP.

8. “Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)” është institucioni përkatës, sipas përcaktimit të ligjit nr.131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të ndryshuar.

9. “Rryma specifike të mbetjeve” janë të gjitha rrymat e mbetjeve të përcaktuara në ligjin nr.10 463/2011, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar.

10. “Skema e PZP”, është tërësia e rregullave, që kanë qëllim të sigurojnë që prodhuesi i cili hedh në treg produkte pjesë e regjimit të rrymave specifike të mbetjeve, të mbajë përgjegjësi financiare dhe organizative për të menaxhuar stadin e mbetjeve në ciklin e jetës së produktit.

11. “Shoqëria për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit” (në vijim “SHPZP”) është shoqëria e themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, me kushtin që nuk shpërndan fitime.

12. “Taksë” është taksa që paguhet nga SHPZP për të marrë përsipër detyrimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

13. “Tregtar” është çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtari tregtare në kuptim të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe paraqet ose shpërndan produktet PZP për shitje tek përdoruesi i fundit.

14. “Vendosje në treg” është furnizimi ose vënia në dispozicion për herë të parë në treg e produktit pjesë e skemës PZP, për qarkullim në tregun shqiptar.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë prodhuesit që zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë aktivitete ekonomike që lidhen me qëllimin e ligjit, nën skemën e PZP dhe hedhin në treg produkte, përdorimi i të cilave krijon mbetje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për këto rryma specifike mbetjesh, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

- a) ambalazhet dhe mbetjet e tyre;
- b) bateritë dhe akumulatorët;
- c) automjetet në fund të jetës;
- ç) mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

3. Ky ligj zbatohet edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore në përmbushje të funksioneve të tyre, me qëllim arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe për vetëqeverisjen vendore.

KREU II
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 5
Strukturat përgjegjëse

1. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) ministria përgjegjëse për mjedisin;
- b) institucioni përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin në mjedis;
- c) institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut;
- ç) institucioni përgjegjës për doganat;
- d) institucioni përgjegjës për tatimet;
- dh) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Institucionet përgjegjëse ushtrojnë detyrat sipas legjislacionit përkatës dhe bashkëpunojnë midis tyre në kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas këtij ligji.

Neni 6
Ministria

Ministria është institucioni përgjegjës për:

- a) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- b) koordinimin ndërinstitutional lidhur me zbatimin dhe mirëfunksionimin e skemës PZP;
- c) pajisjen me autorizim për SHPZP, për ushtrimin e veprimtarive lidhur me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të krijuara nga produktet dhe rrymave specifike të mbetjeve për rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e tyre;
- ç) përgatitjen e procedurave, krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të prodhuesve PZP dhe SHPZP;

d) informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për zbatimin e skemës PZP, kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin

1. Institucioni përgjegjës për kontrollin e skemës së përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit është Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM), si institucioni përgjegjës i kontrollit në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me produktet PZP për:

a) ngritjen dhe funksionimin e regjistrit të produkteve PZP për prodhuesit PZP dhe SHPZP, sipas përcaktimeve të nenit 28 të këtij ligji;

b) verifikimin e të dhënave dhe kontrollin e tregtarit, prodhuesve PZP dhe SHPZP në lidhje me informacionin e përfshirë në raportimet përkatëse pranë Agjencisë, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) kryerjen e kontrollit të strukturave dhe hapësirave ku prodhohen, ruhen, përdoren ose shiten produktet PZP;

ç) kryerjen e kontrollit të tërheqjes së produkteve në rast se nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

2. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, kryejnë këto veprime:

a) inspektime dhe verifikime në importin/eksportin, prodhimin e produkteve PZP dhe në pikat e shitjes së produkteve PZP;

b) kontrole për të analizuar dhe për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave të këtij ligji;

c) organizojnë, në bashkëpunim me operatorët ekonomikë, tërheqjen nga tregu të produkteve PZP në rast se nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji;

ç) mbikëqyrin plotësimin e kërkesave të këtij ligji në vendet ku prodhohen, magazinohen dhe tregtohen produktet PZP.

3. Autoriteti doganor është përgjegjës për kontrollin e produkteve pjesë e skemës së PZP në pikat doganore të hyrjes dhe të daljes.

4. Kontrollat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni kryhen sipas parimeve, procedurave dhe në mënyrën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe për produktet.

KREU III

PËRGJEGJËSITË E PRODHUESIT PZP

Neni 8

Përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesi është përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të produkteve që ka hedhur në treg dhe kostot e lidhura me to, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Ky detyrim zbatohet për produktet e çmontuara që dorëzohen në vendin e pranimit të mbetjeve ose të transportit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.

2. Detyrimi i prodhuesit zbatohet edhe për produktet që prodhuesi hedh në tregun shqiptar dhe produktet që u shiten drejtpërdrejt përdoruesve nëpërmjet shitjes në distancë.

Neni 9

Përgjegjësitë lidhur me skemën e PZP

Prodhuesi, në përmbushje të detyrimeve të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit:

- a) regjistrohet si subjekt i PZP në regjistrin përkatës që administron AKM-ja;
- b) raporton për produktet e vendosura në treg në sasi dhe peshë;
- c) mund të regjistrohet në një SHPZP të autorizuar për produktin përkatës që vendos në treg;
- ç) merr masa që mbetjet e gjeneruara pas përdorimit të produktit të rikuperohen, ripërdoren ose riciklohen;
- d) siguron që SHPZP me të cilën ka një marrëdhënie kontraktuale, përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- dh) nëpërmjet SHPZP bashkëpunon me tregtarët, për të grumbulluar mbetjet në mënyrë të diferencuar nga përdoruesi i fundit.

Neni 10

Përmbushja e objektivave kombëtarë

1. Prodhuesi përmbush objektivat kombëtarë për mbetjet e gjeneruara nga produktet që ka vendosur për herë të parë në treg, të përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.5.2020, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”.

2. Duke filluar nga data 1 Janar 2025, minimumi i objektivave kombëtare që duhen përmbushur për vitin ekzistues, është i barabartë me pjesën që ka prodhuesi në sasi të totale të produkteve PZP të vendosura në treg në vitin paraardhës, të cilat i përkasin të njëjtës kategori mbetjesh për të cilën është subjekt i PZP.

Neni 11

Përgjegjësia financiare

1. Prodhuesi i produkteve PZP merr masa që të mbulojë 100 për qind të kostove që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, si më poshtë:

- a) kthimin e të gjithë produkteve të përdorura dhe mbetjeve të gjeneruara prej tyre;
- b) grumbullimin e diferencuar, magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të paktën për sasinë minimale të objektivit të grumbullimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji;
- c) transportin, rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e rrymave specifike të mbetjeve, të paktën për sasinë minimale të objektivit të trajtimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji;
- ç) zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme informacioni, ndërjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, si dhe rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit;
- d) investimet në infrastrukturën e grumbullimit, me qëllim që të përballojë përzgjedhjen e çdo lloj produkti PZP dhe/ose rrymat specifike të mbetjeve ose kategorinë për të cilin prodhuesi ka detyrime që lindin nga skema e PZP;
- dh) kostot administrative për përmbushjen detyrimeve të vendosura në zbatim të këtij neni.

2. Kostot e paguara nga prodhuesi për të zbatuar detyrimet që lidhen me PZP nuk tregohen veçmas në shitjen e produktit të ri.

Neni 12

Regjistrimi i prodhuesit

1. Prodhuesi që për herë të parë vendos në treg ose importon produkte PZP, regjistrohet pranë AKM, për ushtrimin e veprimtarisë si prodhues PZP.

2. Regjistrimi bëhet nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë për regjistrim e cila përmban të dhënat për prodhuesin, produktet PZP që prodhuesi ka hedhur në tregun vendas dhe llojin e rrymave specifike të mbetjeve të gjeneruara.

3. AKM mban një regjistër *online* për prodhuesit që kanë vendosur në tregun vendas produkte PZP, i aksesueshëm nga publiku vetëm në nivelin e leximit të të dhënave të regjistruara.

4. AKM pajis prodhuesin me çertifikatën e regjistrimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së kërkesës.

5. Prodhuesi i paraqet AKM-së kërkesën për çregjistrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të veprimtarisë së tij.

6. Rregullat për procedurën e regjistrimit, mbajtjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 13

Përbushja e detyrimeve të prodhuesit

1. Prodhuesi përmbush detyrimet që lidhen me skemën e PZP përmes:

a) pagesës së taksës së produktit për detyrimet PZP në mënyrën dhe në masën e përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji, ose

b) pagesës së tarifës së autorizimit ndaj SHPZP.

2. Prodhuesi që përmbush detyrimet e tij PZP nëpërmjet pagesës së taksës së përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji, mban dhe raporton të dhënat në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin për rrymat specifike të mbetjeve.

3. Prodhuesi që përmbush detyrimet e tij PZP nëpërmjet pagesës së tarifës së autorizimit ndaj SHPZP, vërteton përmbushjen e detyrimeve nëpërmjet vërtetimit nga SHPZP ku është i regjistruar.

4. Prodhuesi paraqet një vetëdeklarim për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve për vitin paraardhës, çdo vit, pranë Ministrisë, së bashku me bilancin vjetor, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Prodhuesi i kontraktuar, nëpërmjet SHPZP paraqet në ministri një raport vjetor për sasinë e produkteve PZP të hedhura në tregun vendas, brenda datës 30 prill të vitit pasardhës financiar.

6. Rregullat për mbajtjen, paraqitjen dhe modeli i vetëdeklarimit të prodhuesit dhe vërtetimit të SHPZP për prodhuesin e kontraktuar, sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 14

Ruajtja e të dhënave dhe raportimi

1. Prodhuesi dhe tregtari ruajnë dhe administrojnë të dhënat e mbledhura sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Prodhuesi dhe tregtari mbajnë edhe të dhënat për sasinë e kthyer të mbetjeve, për çdo lloj dhe kategori të tyre, për një vit të caktuar, si dhe të dhënat për dorëzimin e tyre ricikluesve ose trajtuesve të licensuar, në përputhje me parashikimet në ligjin për menxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 15

Detyrimi për informim

1. Prodhuesi vetë, dhe nëpërmjet SHPZZ, informon konsumatorët në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve për:

a) mënyrat e ripërdorimit të produktit si të plotë ose në pjesët përbërëse të tij, mënyrat e çmontimit të produktit, si dhe të trajtimit të mbetjeve të gjeneruara pas përdorimit;

b) dorëzimin e produkteve që gjenerojnë mbetje në pika të afërta grumbullimi lehtësisht të aksesueshme prej tyre dhe të sugjeruara nga prodhuesi;

c) sistemet e ngritura për marrjen mbrapsht dhe grumbullimin e mbetjeve deri në asgjësim;

ç) vendin më të afërt për të dorëzuar mbetjet, në rast refuzimi për të kthyer mbetjet;

d) ndikimin që kanë mbetjet e gjeneruara në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

2. Informacioni jepet në mënyrë të qartë dhe bëhet publik nga ana e prodhuesit dhe tregtarit, duke u publikuar në faqen e internetit të SHPZZ, ose përmes mjeteve të qëndrueshme të komunikimit.

3. Prodhuesi informon tregtarët për mënyrën e kthimit të produkteve të përdorura ose të mbetjeve të krijuara nga konsumatorët, duke përfshirë edhe tregtarin e fundit, që shet dhe/ose i dorëzon produktet konsumatorit.

Neni 16

Taksa e produktit

1. Prodhuesi subjekt i PZZ që vendos në treg produkte për herë të parë, paguan taksën e produktit, e cila përlllogaritet në varësi të produkteve PZZ që hedh në tregun vendas.

2. Taksa e produktit bëhet e detyrueshme duke filluar nga data 1 Janar 2025.

3. Prodhuesi që përmbush detyrimet PZZ përmes pagesës së taksës së produktit, kryen pagesën e parë brenda datës 15 shkurt, për produktet e vendosura në treg gjatë vitit të mëparshëm.

4. Metodologjia për përcaktimin e taksës së produktit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim nga ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për financat.

5. Të ardhurat që krijohen nga pagesa e taksës së produktit konsiderohen të ardhura dytësorë që 70% kalojnë në buxhetin e shtetit dhe 30% kalojnë në fondin special të ekonomisë qarkulluese, për t'u përdorur për përmbushjen e kërkesave të këtij ligji.

6. Ngritja, funksionimi dhe monitorimi i Fondit special i Ekonomisë Qarkulluese miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë përgjegjës për mjedisin dhe Ministrinë përgjegjës për financat.

Neni 17

Detyrimi për regjistrim dhe kontrata me SHPZZ

1. Personi fizik ose juridik në cilësinë e zotëruesit të rrymës specifike të mbetjeve regjistrohet në SHPZZ sipas rrymës përkatëse për të cilën është subjekt i detyrimeve të PZZ.

2. Prodhuesi subjekt i PZZ, nënshkruan një kontratë me SHPZZ për përmbushjen e detyrimeve lidhur me PZZ, për të paktën një vit fiskal.

3. Prodhuesi lidh kontratë të veçantë vetëm me një SHPZZ për çdo rrymë mbetjeje të caktuar.

Neni 18

Informacioni për konsumatorin

1. Tregtari informon me shpenzimet e tij përdoruesin e fundit të produkteve për:
 - a) ndalimin e hedhjes së mbetjeve nga produktet si mbetje bashkiake të padiferencuara dhe detyrimin për grumbullimin e diferencuar të produkteve mbetje;
 - b) sistemet e ngritura për marrjen mbrapsht të mbetjeve nga produktet;
 - c) vendin më të afërt për dorëzimin e mbetjeve nga produktet, në rast refuzimi për të marrë mbrapsht mbetjet nga produktet.
2. Informacioni duhet të jetë i qartë dhe i lehtë për t'u aksesuar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për informimin e konsumatorit.

KREU IV KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I SHPZP

Neni 19 Themelimi i SHPZP

1. SHPZP themelohet si person juridik privat, i organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe këtij ligji dhe regjistrohet pranë QKB.
2. SHPZP themelohet nga të paktën dy prodhues që vendosin në treg produkte PZP dhe ka objekt kryesor menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve të produkteve të vendosura në treg nga ana e prodhuesve themelues dhe prodhuesve të kontraktuar.
3. SHPZP ndalohet të shpërndajë fitime në formën e kuotave për prodhuesit themelues apo të kontraktuar të saj.
4. SHPZP, në përmbushje të detyrimeve të prodhuesve të kontraktuar, ka si qëllim të ngrejë dhe mbajë në funksion skemat e grumbullimit, transferimit dhe trajtimit të produkteve PZP për të cilat është themeluar.
5. SHPZP merr masa që të sigurojë në çdo kohë përmbushjen e përgjegjësive lidhur me PZP.

Neni 20 Përgjegjësitë e SHPZP

1. SHPZP merr përsipër detyrimet PZP të prodhuesve që përfaqësojnë të paktën 25 për qind dhe jo më shumë se 70 për qind të sasive të produkteve PZP të hedhura në treg për çdo vit të ushtrimit të veprimtarisë. Pjesa e tregut llogaritet në bazë të sasisë totale të produkteve PZP për një rrymë të dhënë mbetjesh të vendosur në treg në vitin paraardhës nga të gjithë prodhuesit e regjistruar.
2. SHPZP nënshkruan një kontratë me prodhuesin për një afat prej të paktën 5 (pesë) vjet. Kontrata mbulon detyrimet kryesore të secilës palë sipas kërkesave të këtij ligji dhe përmban parashikime për sasi të parashikuara për çdo rrymë dhe lloj mbetjesh, si dhe përgjegjësitë PZP lidhur me to.
3. Me regjistrimin e saj, SHPZP merr masa të administrojë një sistem të përshtatshëm elektronik për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, me të cilin vërtetohet qartë se detyrimet PZP janë përmbushur për secilin prodhues dhe për rrymat e veçanta të mbetjeve.

Neni 21 Autorizimi i SHPZP

1. Ministria shqyrton aplikimin e SHPZP për autorizim PZP dhe vendos për miratimin ose refuzimin e saj brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita kur ka marrë aplikimin.

2. Autorizimi i PZP -së i jepet SHPZP për aktivitete për menaxhimin e vetëm një rryme mbetjesh sipas legjislacionit në fuqi për menxhimin e integruar të mbetjeve dhe para fillimit të çdo aktiviteti për përmbushjen e detyrimeve PZP nga SHPZP.

3. SHPZP pajiset me autorizim sipas modelit të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për ushtrimin e veprimtarisë për një rrymë specifike, në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

4. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

5. Kushtet e posaçme të autorizimit, dokumentet shoqëruese që paraqiten për pajisjen me autorizim, afati i vlefshmërisë së autorizimit, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e pezullimit dhe anulimit të autorizimeve për SHPZP miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 22

Përmbushja e objektivave kombëtare për mbetjet

1. SHPZP përmbush objektivat kombëtarë për mbledhjen dhe trajtimin e çdo rryme specifike mbetjesh sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni, kur llogariten si total i sasisë së të gjithë prodhuesve të kontraktuar nga SHPZP.

2. Për të përmbushur objektivat për mbetjet, SHPZP nënshkruan kontrata me grumbullues dhe trajtues të licensuar sipas përcaktimeve të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

3. SHPZP njofton prodhuesit e kontraktuar për veprimtaritë lidhur me mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve gjatë vitit paraardhës, duke specifikuar përmbushjen e objektivave minimalë dhe pjesën e tregut, brenda datës 30 prill të vitit pasardhës.

Neni 23

Mospërmbushja e detyrimeve

1. Në rast se SHPZP nuk përmbush objektivat minimalë për mbledhjen dhe trajtimin e një rryme specifike mbetjeje me më shumë se 10 për qind, SHPZP-ja paguan një gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së taksës së produktit.

2. SHPZP zgjidh kontratën me prodhuesin në rast se ky i fundit nuk paguan tarifën e autorizimit për dy periudha të njëpasnjëshme pagesash.

3. SHPZP që zgjidh kontratën sipas pikës 2 të këtij neni, shkarkohet nga detyrimi për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve në përpjesëtim me sasinë për të cilën prodhuesi, nuk ka paguar tarifën e autorizimit.

4. Prodhuesi që zgjidh kontratën me SHPZP, paguan taksën e produktit sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe nuk mund të nënshkruajë kontratë me një SHPZP tjetër gjatë periudhës së vitit fiskal.

5. Pavarësisht largimit nga SHPZP, prodhuesi është i detyruar të regjistrohet në një SHPZP tjetër, nëse kjo e fundit është e autorizuar për atë rrymë mbetjesh në përfundim të vitit fiskal.

6. AKM-ja njofton strukturat inspektuese për mospërmbushjen e objektivave nga SHPZP dhe prodhuesit e kontraktuar brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e konstatimit të mospërmbushjes së tyre. Struktura inspektuese merr masa për vendosjen e gjobës brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.

7. Procedurat për njoftimin e mospërbushjes së detyrimeve dhe vendosjen e gjobës sipas pikës 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Neni 24

Raportimi pranë SHPZP

1. Prodhuesi i paraqet SHPZP një raport tremujor për sasinë e produkteve PZP të vendosur në treg brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës. Ky afat zbatohet edhe në rastin kur prodhuesi nuk ka hedhur në treg asnjë produkt për atë periudhë tremujore.

2. Raportet tremujore për shumën totale të produkteve të vendosura në treg gjatë një tremujori nga të gjithë prodhuesit e kontraktuar nga SHPZP, i dërgohen AKM-së jo më vonë se dita e fundit të muajit pasardhës të atij tremujori.

Neni 25

Tarifa e autorizimit për SHPZP

1. SHPZP njofton me shkrim Ministrinë dhe AKM-në për tarifën e autorizimit për çdo rrymë dhe lloj mbetjeje, si dhe kushtet e përgjithshme të kontratës me prodhuesit brenda datës 15 nëntor të çdo viti, duke nisur nga viti i themelimit të SHPZP.

2. Prodhuesi i paguan SHPZP tarifën e autorizimit çdo tre muaj, sipas kontratës së nënshkruar mes tyre, për sasinë e produkteve dhe rrymave specifike të mbetjejeve që i janë raportuar SHPZP në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

3. Tarifa e autorizimit që prodhuesi ka detyrimin t'i paguajë SHPZP nuk duhet të jetë më pak se 50 për qind e taksës së produktit, subjekt i PZP.

4. SHPZP bën publike të dhënat mbi tarifën e autorizimit dhe kontratat e nënshkruara me prodhuesit, lehtësisht të aksesueshme dhe të dukshme.

5. Tarifa e paguar nga prodhuesit tek SHPZP mbulon plotësisht kostot për përmbushjen e detyrimeve të tyre PZP si më poshtë:

a) kostot për grumbullimin dhe trajtimin për çdo lloj mbetjeje, përfshirë kostot e eliminimit të tepcave të mbetjejeve, nëse ka;

b) kostot operative për veprimtarinë e SHPZP;

c) kostot për komunikimin me publikun dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit;

ç) kostot për investimet në infrastrukturën e mbledhjes së mbetjejeve në mënyrë që të mundësohet përzgjedhja e rrymave specifike dhe llojeve të mbetjejeve për të cilat është autorizuar PRO.

6. Metodologjia për përcaktimin e tarifës së autorizimit për SHPZP përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim nga ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministrin përgjegjës për financat.

Neni 26

Detyrimi për komunikim i SHPZP

1. SHPZP shpenzon një shumë në masën nga 10 deri në 15 për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitete nxitëse dhe promovuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek konsumatorët për këtë ligj dhe për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjejeve, si dhe ndarjen në burim dhe trajtimin.

2. SHPZP shpenzon deri në 20 për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitetet e përmendura në pikën 1, në 3 (tre) vitet e para të autorizimit.

3. SHPZP bashkëpunon me SHPZP të tjera, prodhues, tregtarë, persona të tjerë juridikë, institucione shtetore dhe private, si dhe me Ministrinë për të zhvilluar aktivitete të përshtatshme informacioni, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë.

Neni 27

Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. SHPZP bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe bashkëfinancojnë infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku përdoruesit e fundit dorëzojnë mbetjet pa pagesë, pa rënë ndesh me parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe për vetëqeverisjen vendore.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me SHPZP, në mënyrë që kjo e fundit të ofrojë shërbimet e veta në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore dhe të organizojë dhe zbatojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

3. SHPZP dhe njësia e vetëqeverisjes vendore lidhin një kontratë me shkrim mbi mënyrën e bashkëpunimit. Kjo kontratë mund të përcaktojë që ngritja dhe funksionimi i skemës së PZP të kryhet vetëm nga SHPZP për atë rrymë mbetjesh që ka autorizim, vetëm nga njësia e vetëqeverisjes vendore, ose të dyja së bashku.

4. Kontrata që lidhet sipas pikës 3, të këtij neni mbulon detyrimet kryesore të secilës palë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij. Kontrata përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) kërkesat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke përfshirë rrymën specifike të mbetjeve, numrin e popullsisë për zonën ku ofrohet shërbimi, vendndodhjen e mbetjeve, si dhe periodicitetin e ofrimit të shërbimit;

b) objektivat për grumbullimin e diferencuar, riciklimin dhe rikuperimet e tjera të mbetjeve, si dhe mënyrën e raportimit për përmbushjen e këtyre objektiveve;

c) kushtet dhe afatet për monitorimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji, në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;

ç) kushtet për zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme informacioni, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;

d) kushtet për bashkëfinancimin e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

5. Kushtet e kontratës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve, përgjegjësitë financiare dhe infrastrukurore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për vetëqeverisjen vendore.

KREU V

REGJISTRIMI DHE RAPORTIMI

Neni 28

Regjistri i produkteve të prodhuesve PZP dhe SHPZP

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon një bazë të dhënash në regjistrin elektronik për prodhuesit për çdo produkt PZP dhe të SHPZP-ve të autorizuar në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

2. Regjistri i prodhuesve PZP përmban informacion në lidhje me produktet PZP dhe rrymat e veçanta të mbetjeve për të cilat ka përgjegjësi prodhuesi.

3. Regjistri i SHPZP përmban informacion në lidhje me prodhuesit themelues dhe të kontraktuar të SHPZP, si dhe produktet PZP dhe sasinë totale të rrymave specifike të mbetjeve të grumbulluara dhe trajtuara nga çdo skemë PZP për çdo vit të ushtrimit të veprimtarisë.

4. Prodhuesit PZP dhe SHPZP të regjistruar në regjistrat përkatës raportojnë pranë Agjencisë çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Verifikimi i të dhënave të regjistrit të prodhuesve PZP dhe SHPZP bëhet nga struktura përgjegjëse në AKM të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

6. AKM-ja publikon dhe përditëson çdo vit regjistrin me të dhënat për sasinë totale të produkteve PZP, sipas llojit dhe rrymave të mbetjeve të krijuara.

7. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të produkteve PZP dhe SHPZP, detyrimet e prodhuesit PZP dhe SHPZP për të raportuar, si dhe niveli i aksesueshmërisë së regjistrit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 29

Raportimi vjetor

1. Prodhuesi PZP dhe SHPZP raporton në Ministri dhe AKM çdo 6 (gjashtë) muaj, në dy vitet e para të regjistrimit dhe autorizimit të tij dhe pas këtij afati, raportimi është një herë në vit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

2. Prodhuesi PZP dhe SHPZP paraqesin brenda datës 30 prill të çdo viti në strukturën përgjegjëse në ministri dhe AKM, raportin vjetor për produktet PZP të hedhura në treg, të audituar nga auditues i licensuar.

3. Raporti përmban të dhëna për sasinë totale të produkteve PZP të vendosura në treg, sasinë e mbledhura dhe të trajtuara sipas produktit PZP dhe rrymave specifike të mbetjeve dhe përmbushjen e objektivave kombëtarë të mbetjeve.

4. Formati dhe mënyra e përgatitjes dhe dorëzimit të raportit vjetor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

5. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe AKM merr masat e nevojshme për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të dorëzuar sipas këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI

Neni 30

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas kufijve dhe përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin.

2. Dënohen me gjobë shkeljet e mëposhtme:

a) mospërbushja e detyrimit të prodhuesit të produkteve PZP lidhur me mbulimin e kostove për ngritjen dhe funksionimin e skemës PZP, sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

b) mosparaqitja e vetëdeklarimit ose e vërtetimit të SHPZP për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 13 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 200 000 lekë deri në 500 000 lekë;

c) mospagimi i taksës së produktit dhe tarifës për autorizimin e SHPZP dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 2 000 000 lekë;

ç) mospërbushja e detyrimit për raportimin periodik dhe vjetor nga ana e prodhuesve PZP dhe SHPZP, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

d) dhënia e informacionit të pasaktë nga ana e prodhuesve PZP dhe SHPZP, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

dh) mospërbushja e detyrimeve për informimin e konsumatorëve, sipas parashikimeve të nenit 15 dhe 18 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 500 000 lekë;

e) hedhja në treg dhe tregtimi i produkteve që nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

3. Gjoha paguhet brenda një periudhe prej 10 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për vënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Të ardhurat e mbledhura nga gjokat derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit.

5. Në rast se SHPZP nuk arrin të përmbushë detyrimet e prodhuesit për PZP dhe objektivat e lidhura me to, si dhe/ose është në pamundësi financiare për të paguar penalitetet për mospërbushjen e detyrimeve, këto të fundit paguhen nga prodhuesi, në përputhje me përqindjen e produkteve të vendosura në tregun vendas, për vitin në të cilin objektivi nuk është përmbushur.

Neni 31

Procedura e kundërvajtjeve administrative

1. Konstatimi i kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 30 të këtij ligji dhe vendosja e gjobës bëhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis.

2. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur bëhet ankim në Komisionin e Ankimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

3. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar nga Komisioni i Ankimit, ekzekutimi dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

4. Kundër vendimit të Komisionit të Ankimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit bëhet ankim në gjykatë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 32

Pezullimi dhe anulimi i autorizimit

1. Pavarësisht nga dënimet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “dh” të pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, i propozon ministrit përgjegjës për mjedisin:

a) pezullimin e autorizimit për SHPZP në rastet kur:

i. paraqitet kërkesë nga SHPZP;

ii. SHPZP nuk përmbush kushtet e parashikuara në autorizim dhe kërkesat e këtij ligji;

b) anulimin e autorizimit të SHPZP në rastet kur:

i. paraqitet kërkesë nga SHPZP;

ii. SHPZP ka shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat e këtij ligji, gjë që ka çuar në vënien e gjobave administrative në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;

iii. SHPZP nuk ka zbatuar brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara si shkaqe të pezullimit;

iv. SHPZP nuk ka paguar gjobat administrative të vëna sipas këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për mjedisin nxjerr urdhrin e pezullimit të autorizimit, duke i lënë subjektit një afat prej 20 ditësh për ripërmbushjen e shkaqeve të pezullimit.

3. Subjekti ndaj të cilit vendoset urdhri i pezullimit, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në rast se subjekti plotëson detyrimet për shkaqet e pezullimit, ministri shfuqizon urdhrin e pezullimit.

5. Në rast se subjekti nuk përmbush brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara në shkaqet e pezullimit, ministri nxjerr urdhrin e anulimit të autorizimit përkatës.

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit publikon aktin e pezullimit apo anulimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

8. SHPZP ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit administrativ sipas afateve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.

9. Kundër vendimit të ministrit, SHPZP ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 6; 13, pika 6; 16, pika 4; 23, pika 7; 25, pika 6; 27, pika 5; dhe 28, pika 7, të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin që brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29, pika 4, të tij.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për vetëqeverisjen vendore që brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 27, pika 5, të tij.

Neni 34

Dispozita kalimtare

Produktet që janë vendosur në treg dhe janë subjekt i PZP, kur nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, lejohet të tregtohen deri në 2 (dy) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 35
Shfuqizimet

Të gjitha aktet që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen pas fillimit të efekteve të këtij ligji.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më 1 janar 2025.

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA

[shqiptarja.com]